



Vëzhgohen aktivitete të rrezikshme nga Serbia për sulm “hibrid” potencial ndaj Kosovës: Veprimet e koordinuara vendore dhe ndërkombëtare janë me urgjencë

Instituti Octopus është i angazhuar në mënyrë aktive në monitorimin e situatës në zhvillim në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht dinamikën në Serbi në kontekstin e pranimin të Kosovës në Këshillin e Evropës. Me afrimin e këtij momenti të rëndësishëm diplomatik, analiza jonë tregon se Serbia është duke intensifikuar përpjekjet e saj për të penguar hyrjen e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Nga aspekti politik Serbia është angazhuar që ta ndalojë avancimin e Kosovës në Këshillin e Evropës duke bindur edhe vende të NATO-së që të votojnë kundër Kosovës. Serbia ka arritur që ta shtyjë Malin e Zi, një vend që e njeh Republikën e Kosovës dhe është anëtar i NATO-së që të votojë kundër Kosovës në Këshillin e Evropës. Serbia duke dashur të kërcënojë vendet perëndimore, deklaroi se ata mund të tërhiqen nga ky institucion nëse Kosova bëhet vend anëtar. Me këtë veprim Serbia nuk po i përmbahet marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Sipas këtyre marrëveshjeve, Kosova dhe Serbia nuk duhet që ta pengojnë njëra-tjetrën në rrugën e tyre të avancimit në institucionet ndërkombëtare. Këto shkelje të marrëveshjeve nga Serbia bien ndesh edhe me konventat dhe zakonet ndërkombëtare.

Reagimi i Serbisë ndaj anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës duket të jetë i shumëanshëm, duke arritur përtej protestave diplomatike konvencionale dhe në fushën e veprimeve të fshehta që mund të kenë implikime të thella për stabilitetin rajonal. Analiza jonë tregon se Serbia, e përballur me realitetin e afërt të humbjes së një beteje të rëndësishme

diplomatike, mund të jetë duke u drejtuar ndaj masave që janë sa jokonvencionale aq edhe alarmante.

Informacionet e fundit sugjerojnë vendosjen e njësisë të armatosura nga shërbimet e inteligjencës serbe nën maskën e përpjekjeve dhe operacioneve kundër terrorizmit. Kjo lëvizje, e cila gjoja synon të frenojë kërcënimin e terrorizmit radikal islamik, ngre pyetje serioze në lidhje me qëllimet reale. Koha dhe natyra e këtyre dislokimeve lë të kuptohet për një agjendë me qëllim malinj: fabrikimin e mundshëm të incidenteve terroriste që mund t'i atribuohen në mënyrë të rreme ekstremistëve islamikë.

Kjo taktikë, edhe pse brutale dhe tronditëse, nuk është pa precedent. Komuniteti global është ende i shqetësuar nga pasojat e sulmeve shkatërruese në Moskë, që i atribuohen ISIS-it, të cilat morën mbi 140 jetë. Duke përdorur këtë skenar, mundësia që Serbia mund të orkestrojë sulme të ngjashme brenda kufijve të saj, apo edhe në Kosovë, për ta portretizuar veten si viktimë e terrorizmit, nuk mund të hidhet poshtë. Veprime të tilla do të shërbenin për objektiva të shumëfishta për Serbinë: përfitimin e simpatisë ndërkombëtare, komplikimin e kërkesës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe forcimin e qëndrimit të saj kundër pavarësisë së Kosovës.

Kjo strategji rrezikon të ndezë tensionet në një rajon që ende po shërohet nga plagët e konflikteve të kaluara. Fabrikimi i kërcënimeve terroriste, veçanërisht kur i atribuohet ekstremizmit islamik, mund të nxisë ndarjet dhe të pengojë procesin e brishtë të pajtimit midis komuniteteve të ndryshme në Ballkan.

Instituti Octopus i kërkon komunitetit ndërkombëtar që t'i qaset kësaj shtate me një sy kritik dhe të marrë parasysh kontekstin e veprimeve të Serbisë. Është thelbësore të bëhet dallimi midis shqetësimeve legjitime të sigurisë dhe taktikave manipuluese që synojnë të shfrytëzojnë spektrin e terrorizmit për përfitime politike. Meqë Kosova ndodhet në pragun e një kapitulli të ri në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, integriteti i procesit duhet të mbrohet nga çdo formë e luftës hibride që synon ta minojë atë.

Në këtë kontekst, Instituti Octopus rekomandon që strukturat ndërkombëtare dhe vendore të sigurisë të rrisin vigjilencën dhe kapacitetet e sigurisë sidomos në vendet e banuara me shumicë serbe në Kosovë, dhe me popullsi etnikisht të përzier, në të cilat ekziston rreziku i instrumentalizimit nga Serbia për motive destruktive të minimit të paqes në Ballkanin Perëndimor. Instituti Octopus duke ndjekur përgatitjet e Serbisë për të shfrytëzuar momentume të caktuara për sulm ndaj Kosovës, kërkon vëmendjen e plotë nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore, në

veçanti nga BE-ja, NATO dhe vendet e QUINT-it, që të mos neglizhojnë angazhimin e tyre ushtarak, vëzhgues, politik dhe diplomatik në parandalimin e qëllimeve të Serbisë kundër Kosovës dhe rajonit.

Tolerimi dhe mosreagimi ndaj shkeljeve të sigurisë dhe kërcënimeve të Serbisë është nxitje për këtë të fundit që të shkelë vijat kufitare me Kosovën dhe vendet e tjera të rajonit në forma hibride, terroriste, paraushtarake apo konvencionale, duke akomoduar edhe interesin e Ruisë për krijimin e vatrave të reja të luftës në botë.

Një reagim i koordinuar vendor dhe ndërkombëtar do t'i kontribuonte jo vetëm paqes dhe sigurisë në Kosovë, por edhe në rajon dhe më gjerë.

Instituti Octopus është duke mbajtur nën vëzhgim situatën në vazhdimësi dhe ne do të vazhdojmë të ofrojmë analiza të bazuara nga të dhënat konkrete nga terreni.